



Pranuar / Dostiguar Punëpunë/Predato Received/Delivered	09.03.2023	3	viti god year
Organ /Njësia Org./Unit	Nr. Prot. Pr. No.	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHCK	2530/2023		115



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.301/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari-dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, si dhe Vjollca Sinani -Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.301/2023 të datës 02.02.2023 e parashtruar nga ankuesi kundër organit të punësimit Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në çështjen juridike “Kompensim Material”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, Nenin 16 paragrafi 3 ,nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 09.03.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.301/2023 e datës 02.02.2023, e parashtruar nga ankuesi
- II. Mbetet në fuqi Vendimi KA.nr.02/2023 i datës 13.01.2023 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës në Gjykatën Themelore në Prizren, sipas Akt emërimit i datës 31.11.2018 në pozitën “Zyrtar Çertifikues”, me koeficient të pagës nëntë (9), më datë 02.02.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 1243/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit KA.nr.02/2023 të datës 13.01.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave pranë Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me pretendimet ankimore për shkelje të dispozitave procedurale, ligjit material dhe konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 15.02.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Shërbimin Korrektues të Kosovës. Ndërsa Këshilli, me datë 27.02.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga organi i punësimit me numër protokollit 2130/2023 së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritior ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 1243/2023 të datës 02.02.2023 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Vendimi i datës 13.01.2023 nga Komisioni i Ankesave ne SKGJK; Kërkesë për harmonizimin e koeficientit e datës 03.12.2021; Akt emërimi i datës 30.11.2018 i ankuesit; Procedim në sistemimin e pagave i KGJK-së, datë 23.02.2018; Kërkesë për harmonizimin e koeficientit e datës 28.07.2022; Aktgjykim i datës 29.09.2021 i Gjykatës Themelore ne Prishtinë; Aktgjykim i datës 07.06.2022 i Gjykatës Apelit të Kosovës; Aktgjykim i datës 02.11.2022 e Gjykatës Supreme të Kosovës; Ankesën të datës 15.12.2022 të parashtruar në Komisionin për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave ne SKGJK; Vendimi i datës 29.11.2022 nga SKGJK; Vendimi i datës 27.12.2017 nga SKGJK; Shkresë nga DASHC/MAP-04/32 datë 23.02.2018.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesit është e pa bazuar, **SEPSE:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës është konstatuar se ankuesi sipas Akt emërimit të datës 31.11.2018 në pozitë "Zyrtar Çertifikues", ishte me koeficient të pagës nëntë (9) deri më datë 29.11.2022 kur sipas kërkesës së ankuesit të datës 28.07.2022 Këshilli Gjyqësor i Kosovës përmes vendimit DS-1178/2022, referuar Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë A.nr.2548/18 të datës 09.09.2021 i plotfuqishëm nga data 25.10.2022 ndërsa i ekzekutueshëm nga data 08.11.2022 ngase ishte vërtetuar përmes aktgjykimit të Gjykatës së Apelit AA.nr.949/2021 të datës 07.06.2022 dhe Gjykatës Supreme ARJ-UZVP.nr.66/2022 të datës 02.11.2022, i ishte harmonizuar koeficienti nga nëntë(9) në dymbëdhjetë(12), ndërsa Ankuesi me datë 15.12.2022 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me pretendimin ankimor për anulimin e vendimit DS-1178/2022 të datës 29.11.2022 dhe që përveç harmonizimit të koeficientit të i bëhet edhe pagesa retroaktive e diferencës së koeficientit nga nëntë(9) në dymbëdhjetë(12), në mënyrë retroaktive nga data 30.11.2018 kur edhe është caktue në pozitën "Zyrtar Çertifikues", duke pretenduar që kërkesa është e bazuar në Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë A.nr.2548/18 të datës 09.09.2021 i plotfuqishëm nga data 25.10.2022 ndërsa i ekzekutueshëm nga data 08.11.2022 ngase ishte vërtetuar përmes aktgjykimit të Gjykatës së Apelit AA.nr.949/2021 të datës 07.06.2022 dhe Gjykatës Supreme ARJ-UZVP.nr.66/2022 të datës 02.11.2022.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në kuadër të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor, ka trajtuar ankesën e ankuesit ndërsa me datë 13.01.2023 përmes Vendimit KA.nr.02/2023 ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pa bazuar me arsyetimin se me Vendimin DS-1178/2022 të datës 29.11.2022 të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës i është harmonizuar paga/koeficienti i ankuesit si zyrtarë çertifikues në Gjykatën Themelore në Prizren nga nëntë(9) në dymbëdhjetë(12)

bazuar në Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë A.nr.2548/18 të datës 09.09.2021 i plotfuqishëm nga data 25.10.2022 ndërsa i ekzekutueshëm nga data 08.11.2022 ngase ishte vërtetuar përmes aktgjykimit të Gjykatës së Apelit AA.nr.949/2021 të datës 07.06.2022 dhe Gjykatës Supreme ARJ-UZVP.nr.66/2022 të datës 02.11.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave konstaton se në lidhje me pretendimin sa i përket anulimit të vendimit KA.Nr.02/2023 të datës 13.01.2023 nga Komisioni i Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës konsideron se është i pabazuar për faktin se përmes këtij vendimi pikërisht ishte refuzuar ankesa që kërkonte që të anulohet vendimi DS-1178/2022 i datës 29.11.2022 si tërësi ,që pikërisht ankuesit i ishte aprovuar kërkesa e datës 28.07.2022 për harmonizim të koeficientit nga nëntë(9) në dymbëdhjetë(12),andaj mbi këtë bazë përkundër që ankuesi ishte i kënaqur me harmonizimin e koeficientit, kërkonte që i njëjti vendim në tërësi të anulohet mbi bazën e një kërkesë tjetër që lidhet me pagesën retroaktive të diferencës së koeficientit nga nëntë(9) në dymbëdhjetë(12),andaj në këtë kuptim kolegji i këshillit nuk ka gjetur ndonjë elementë të qëndrueshëm bazuar në shkresat e lëndës dhe bazë ligjore mbi bazën e një konstatimi real të gjendjes faktike për aprovim të ankesës sa i përket kësaj pjese të pretendimit të ankuesit e rrjedhimisht edhe pretendimi i ankuesit mbi këtë bazë është i paqëndrueshëm, për faktin se i është realizuar kërkesa për harmonizim të koeficientit sipas kërkesës së ankuesit të datës 28.07.2022 sipas vendimit DS-1178/2022 të datës 29.11.2022 dhe i konfirmuar pikërisht përmes vendimit KA.Nr.02/2023 të datës 13.01.2023 nga Komisioni i Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave lidhur me pretendimin për realizimin e diferencës së koeficientit të pagës në mënyrë retroaktive nga data 30.11.2018,datë kur ankuesi është caktuar në këtë pozitë të "Zyrtarit Çertifikues" e deri më datë 29.11.2022, kur është nxjerrë vendimi DS-1178/2022 nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës bazuar në Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë A.nr.2548/18 të datës 09.09.2021 i plotfuqishëm nga data 25.10.2022 ndërsa i ekzekutueshëm nga data 08.11.2022 ngase ishte vërtetuar përmes aktgjykimit të Gjykatës së Apelit AA.nr.949/2021 të datës 07.06.2022 dhe Gjykatës Supreme ARJ-UZVP.nr.66/2022 të datës 02.11.2022, përkundër që në shkresat e lëndës gjenden shkresat,KGJK,Nr.366/2017 e datës 27.12.2017 dhe shkresa nga DASHC/MAP-04/32 datë 23.02.2018 që konfirmonin koeficientin e "Zyrtarëve Çertifikues" dymbëdhjetë(12),me qëllim që koeficienti për këtë pozitë të jetë i njëjtë në sistem Gjyqësor dhe Prokurorial, por se nga shkresat e lëndës të dorëzuar nga palët në këtë procedurë kolegji i këshillit nuk ka mundur të gjejë asnjë shkresë/kërkesë apo ndonjë fakt që konfirmon se ankuesi kishte ndërmarrë ndonjë veprim administrativë konform afateve ligjore me qëllim që të harmonizohet koeficienti konform dy shkresave të potencuara si më lartë që definojnë koeficientin për këtë pozitë që mbanë ankuesi përkatësisht i njëjti një veprim të tillë e ka ndërmarrë tek më datë 03.12.2021 dhe 28.07.2022, kur i është aprovuar kërkesa për harmonizim të koeficientit nga nëntë(9) në dymbëdhjetë(12) përmes vendimit DS-1178/2022 të datës 29.11.2022, në këtë kuptim kolegji i këshillit vlerëson se ankesa e parashtruar në KZKA lidhur me pretendimin për realizimin e diferencës së koeficientit të pagës në mënyrë retroaktive nga data 30.11.2018,datë kur ankuesi është caktuar në këtë pozitë të "Zyrtarit Çertifikues" e deri më datë 29.11.2022, kur është nxjerrë vendimi DS-1178/2022 nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës bazuar në Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë A.nr.2548/18 të datës 09.09.2021 i plotfuqishëm nga

data 25.10.2022 ndërsa i ekzekutueshëm nga data 08.11.2022 ngase ishte vërtetuar përmes aktgjykimit të Gjykatës së Apelit AA.nr.949/2021 të datës 07.06.2022 dhe Gjykatës Supreme ARJ-UZVP.nr.66/2022 të datës 02.11.2022 ,është jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 8 paragrafin 2 të Rregullores Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, ku është përcaktuar se: *"...Ankesa duhet të paraqitet brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga momenti kur nëpunësi civil konsideron se i janë shkelur të drejtat e tij nga marrëdhënia e punës"* si dhe nenin 127 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative me të cilin përcaktohet se *"Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ "*,dhe me qenë se kemi në shkresat e lëndës dy prova përkatësisht dokumente zyrtare-shkresa të ofruara nga palët në procedurë, KGJK,Nr.366/2017 e datës 27.12.2017 dhe shkresa nga DASHC/MAP-04/32 datë 23.02.2018 që konfirmonin koeficientin e *"Zyrtarëve Çertifikues"* dymbëdhjetë(12),dhe me qenë se ankuesi në këtë pozitë ishte nga data 31.11.2018 ndërsa dy shkresa në lidhje me këtë çështje ishin me datë 03.12.2021 dhe 28.07.2022 ndërsa kolegji nuk ka hasur në asnjë shkresë/kërkesë tjetër që ankuesi brenda afatit ligjor të specifikuar si më lartë të ketë ndërmarrë ndonjë veprim administrativ për realizim të kërkesës dhe në këtë kuptim rezulton se pretendimi ankimor i ankuseses për kompensimin e pagesës retroaktive për diferencën e koeficientit në mënyrë retroaktive është i pabazuar.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e vendimmarrjes sa i përket kësaj ankese analizoi edhe pretendimin sa i përket çështjes së pagesës së diferencës në koeficient i cili pretendon se pagesa duhet të i realizohet në mënyrë retroaktive bazuar në Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë A.nr.2548/18 të datës 09.09.2021 i plotfuqishëm nga data 25.10.2022 ndërsa i ekzekutueshëm nga data 08.11.2022 ngase ishte vërtetuar përmes aktgjykimit të Gjykatës së Apelit AA.nr.949/2021 të datës 07.06.2022 dhe Gjykatës Supreme ARJ-UZVP.nr.66/2022 të datës 02.11.2022,nga data 30.11.2018,datë kur ankuesi është caktuar në këtë pozitë të *"Zyrtarit Çertifikues"* e deri më datë 29.11.2022,ndërsa kolegji i këshillit konsideron se ky pretendim është i pabazuar për faktin se institucioni në këtë rast Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës nuk ka pasur ndonjë obligim ligjor-gjyqësor për pagesë të retroaktivit për diferencë të koeficientit nga se ankuesi nuk kishte qenë palë në këtë procedurë gjyqësore dhe se aktgjykimi që i referohet ankuesi obligon institucionin vetëm për pagesën e retroaktivit për paditësit që kanë qenë në këtë procedurë gjyqësore, andaj mbi këtë bazë pretendimi është i pabazuar, dhe se drejtë ka vendosë Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës përmes Vendimit të atakuar me këtë ankesë, KA.nr.02/2023 të datës 13.01.2023 .

Rrjedhimisht, Kolegji i Këshillit vlerëson se Vendimi KA.nr.02/2023 i datës 13.01.2023 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nuk është konstatuar se ka shkelje procedurale me rastin e vendimmarrjes ,dhe po ashtu me aktin e kontestuar është vërtetuar drejtë gjendja faktike dhe drejtë është zbatuar ligji material, dhe mbi këto baza ligjore të specifikuara si më lartë përkatësisht në arsyetim të këtij vendimi i njëjti është lënë në fuqi.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1,nenin 16 paragrafi 3 ,nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132

paragrafit 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.301/2023, datë 09/03/2023

Vjollca SINANI

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit,
- Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (SKGJK);
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në SKGJK; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

